

VENDIM
Nr.207, datë 10.3.2020

PËR DHËNIE SHPËRBLIMI PËR PERSONELIN, MJEKË, INFERMIERË DHE PUNONJËS TË TJERË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, për personelin mjekësor, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik, të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.

2. Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë), lekë, për personelin mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.

3. Shpërblimi, sipas pikës 1, të këtij vendimi, do t’u jepet edhe mjekëve dhe infermierëve që kanë dalë në pension dhe dëshirojnë të ofrojnë shërbim shëndetësor për trajtimin e personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.

4. Lista emërore e përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, miratohet çdo muaj me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

5. Fondi për shpërblimin e personelit, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë, sipas pikave 1, 2 e 3, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2020.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama